VENDIM
Nr. 129, datë 29.8.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN SHOQËRISË "AYEN AS ENERGJI" SHA, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d" dhe nenit 10, pikat 1, dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 79/7 prot, datë 26.8.2019 nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për licencimin e shoqërisë "Ayen As Energji" sha në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria "Ayen AS Energji" sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 515/1 prot., datë 22.8.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

- Shoqëria "Ayen AS Energji" sh.a., zotëron licencën për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me nr. 245, seria Fk14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 83, datë 16.9.2014, për një periudhë 5-vjeçare, periudhë e cila përfundon në datën 16.09.2019.

- Në nenin 16, pika 1 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", parashikohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë "Ayen AS Energji" sha, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c"). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e"), Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d"). Plotësuar në mënyrë pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c", "e", "d", "f". Plotësuar pjesërisht.

- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7, germa "b", "c"). Plotësuar.

- Në lidhje me azhurnimin e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 1, germa "a".

- Nenin 9, pika 3, germa "a" (vërtetim për shlyerje tatim-taksash dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) do t'i kërkohet subjektit të sjellë vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave dhe nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore.

- Nenin 9, pika 4, germa "c"(lista e kontratave të mëparshme për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike).

- Nenin 9, pika 4, germa "d" (informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e kontratave);

- Nenin 9, pika 4.7, germa "a". Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "AYEN AS ENERGJI" sha., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5-vjeçarë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti